



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

KEC

Kodi: 055

GEOGEBRA PËR KLASAT 1-5

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Programi “GeoGebra për klasat 1-5” është rezultat i bashkëpunimit në mes të Qendrës për Arsim e Kosovës (KEC) dhe Institutit Ndërkombëtar të GeoGebra (IGI). Programi ka filluar të realizohet në Kosovë nga nëntori i vitit 2011, pas pranimi të Institutit GeoGebra të Prishtinës, i cili operon nën ombrellën e KEC, në rrjetin e IGI.

Programi i trajnimit mbështetet në modulën që shfrytëzojnë shtetet e ndryshme partnere të IGI në zbatimin e programit të GeoGebra, i cili është pasuruar edhe me modele të mësimi të zhvilluara nga grupi i ekspertëve vendorë dhe i mësimdhënësve që kanë marrë pjesë në trajnimin për trajnerë të organizuar nga KEC. Po ashtu programi shfrytëzon dhe materialet e ndryshme të cilat janë publikuar në webfaqen e ndërkombëtare të IGI.

Qëllimet e Programit

Me përvetësimin e këtij Programi pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje:

- Të njohin pjesët përbërëse të programit GeoGebra dhe funksionet e “vegllave” për përgatitjen e njësive mësimore në lëndën e matematikës.
- Të përdorin programin e GeoGebra për të konkretizuar përvetësimin e koncepteve, rregullave dhe procedurave për zgjidhjen e detyrave të ndryshme në këtë lëndë.
- Të zhvillojnë te nxënësit shkathtësitë për zgjidhjen e detyrave problemore, për analizë të mundësive të zgjidhjes varësisht nga kushtet e dhëna, si dhe nxjerrje të përfundimeve të vlefshme.
- Të shfrytëzojnë programin GeoGebra për të përshtatur mësimdhënien e matematikës nevojave dhe interesimeve të nxënësve duke bërë diferencimin e mësimdhënies përmes planifikimit të aktiviteteve për të gjithë nxënësit, si dhe zhvillimin e qasjes së të nxënësit të vetë-inicuar tek nxënësit
- Të ndihmojnë nxënësit në arritjen e rezultateve të të nxënësit të lëndës së matematikës.
- Të bëhen burim përvojë dhe njohurish për mësimdhënësit e tjerë.

Përmbajtja

Prezantimi i disa programeve të matematikës dinamike. Prezantimi i programit GeoGebra. Përparësitë e shfrytëzimit të programit të GeoGebrës në procesin e mësimdhënies së matematikës. Sqarimi i veçlave të programit të GeoGebrës. Prezantimi i disa mësimëve model me programin e GeoGebrës. Analiza e mësimëve model. Zhvillimi i kompetencave të nxënësve përmes përdorimit të programit të GeoGebrës. Përgatitja e një mësimi model me GeoGebra. Prezantimi i disa mësimëve model për zbatim në klasë dhe diskutimi i tyre.

Grupi i synuar

Ky program i dedikohet mësimdhënësve të Matematikës të shkollave fillore (klasat 1-5). Po ashtu, programi mund të jetë i dobishëm edhe për studentët e fakultete që përgatisin mësimdhënësit e ardhshëm.

Metoda e punës për realizimin e programit

Programi organizohet në formë të seminarit 2-ditorë. Gjatë trajnimit prezantohet programi dinamik GeoGebra, si dhe mënyra e shfrytëzimit të tij në prezantimin e temave të ndryshme nga lënda e matematikës. Në veçanti i kushtohet kujdes shtjellimit të pjesës praktike të zbatimit të programit, sepse ajo ndihmon aftësimin e mësimdhënësve për të përgatitur mësimë model, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave të caktuara të nxënësit. Numri optimal i pjesëmarrësve në trajnim është 20-25.

Programi ka gjithsej **16 orë**.

Vlerësimi/Certifikimi

Kusht për certifikimin për pjesëmarrje është përcjellja me rregull e seminareve mbi 80 % dhe përgatitja e dy mësimëve model nga lënda e matematikës.

Materialet e trajnimit

Punime për fillestarë në GeoGebra, KEC, 2012.